

BULETINI II

Fondacioni Kosovar për Zhvillim të Karrierës - KCDF



Fushëveprimtaria e organizatës

Fondacioni Kosovar për Zhvillim të Karrierës (KCDF) është organizatë jofitimprurëse e themeluar për të avokuar dhe promovuar edukimin dhe orientimin në karrierë, ndërmarrësinë si dhe ndërlidhjen midis sistemit arsimor dhe tregut të punës në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i organizatës përfshin edukimin dhe trajnimet, hulumtimet dhe punësimin. KCDF vepron si organ ndërmjetësues dhe koordinues midis organizatave publike dhe atyre joqeveritare të përfshira në këtë sektor, duke siguruar që palët të veprojnë në mënyrë të bashkërenduar.

ZHVILLIMI NË
KARRIERË DHE
NDËRMARRËSI

Aktivitetet, ngjarjet dhe
bashkëpunimet me
partnerë.



KLUBET E KARRIERËS NË GJIMNAZE



AFTER SCHOOL SUPPORT
FOR TEENS

Roli dhe rëndësia e Klubeve

“PËRKRAHJE ADOLESHENTËVE PAS MËSIMIT TË RREGULLT” /
“AFTER SCHOOL SUPPORT FOR TEENS” - ASSET PROGRAM,
I FINANCUAR NGA USAID



QËLLIMI I KLUBIT

Krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm në shkollë për organizimin e aktiviteteve të ndërlidhura me orientim në karrierë, si dhe rrjetëzimin dhe bashkëpunimin me biznese vendore për këshilla dhe ofrimin e praktikave të punës.

PËRGJEGJËSITË E KLUBIT

- Organizimi i hapësirës dhe pajisjeve për klubin.
- Furnizimi me materiale shpenzuese.
- Krijimi i vizibilitetit fizik dhe virtual.
- Konkretizimi i objektivave specifike të klubit.
- Përpilimi dhe aprovimi i planit të hollësishëm vjetor.
- Zhvillimi i kapaciteteve të anëtarëve të klubit për menaxhimin e klubit (organizimi i takimeve, mbajtja e procesverbaleve, dokumentimi, komunikimi, bashkëpunimi).
- Zhvillimi i kapaciteteve për organizimin e ngjarjeve.



HAPAT E THEMELIMIT TË NJË KLUBI

- Marrja e aprovimit dhe përkrahjes nga drejtori e shkollës.
- Caktimi i një mësimdhënësi si mentor i klubit, mundësisht nga fusha Jeta dhe Puna dhe/apo i trajnuar për orientim dhe këshillim në karrierë.
- Publikimi i shpalljes për anëtarësinë në klub nga nxënësit e shkollës.
- Përzgjedhja e nxënësve për anëtarë të klubit dhe ndarja e detyrave, duke siguruar përfaqësim të barabartë gjinor dhe etnik nga klasat 10, 11 dhe 12.

IDEJA E THEMELIT TË KLUBEVE TË KARRIERËS NË KOSOVË

Pasi gjimnazet nuk kanë ekip të mjaftueshëm për koordinimin e aktiviteteve për orientim dhe këshillim për karrierë Programi “Përkrahje adoleshentëve pas mësimit të rregullt” – Programi ASSET, inicioi themelimin e klubeve të karrierës në 16 gjimnazet partnere.

Këto klube udhëheqen nga një mësimpldhënës mentor. Të gjitha klubet mbështeten nga Programi përmes mentorimit në realizimin e aktiviteteve të tyre.

Si rezultat, që nga themelimi i klubeve, nga viti 2018 deri më tani, rreth 500 nxënës, anëtarë të klubeve të karrierës, kanë:

- Identifikuar mbi 70 biznese dhe organizata vendore të gatshme për bashkëpunim me shkollat.
- Menaxhuar nënshkrimin e marrëveshjeve mes shkollave dhe bizneseve.
- Koordinuar praktikat e shkurta të punës në bizneset partnere për 165 nxënës.
- Organizuar sesione për bashkëmoshatarët për qasje dhe gjetje të informatave në platformën për karrierë Busulla.COM.
- Shkrimin e CV-së dhe letrës motivuese.
- Menaxhimin e medieve digjitale.
- Trajnim për punë ekipore, etj.
- Organizuar mbi 60 sesione informuese për bashkëmoshatarët me profesionistë të fushave të ndryshme, në shkollë dhe online.



“

ZHVILLIMI I
SHKATHTËSIVE
PËR PUNËSIM DHE
NDËRMARRËSI TEK TË
RINJTË DUKE KRIJUAR
BOTËKUPTIM POZITIV
PËR TË ARDHMEN E
TYRE.

”

Programi i USAID-it “After School Support for Teens” (ASSET) – “Përkrahje adoleshentëve pas mësimit të rregullt” është program 5-vjeçar që menaxhohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në partneritet me FHI 360 dhe Crimson Capital Corp.

RËNDËSIA E SHKATHTËSIVE TË BUTA PËR JETË DHE PUNË



SHKATHTËSITË E BUTA

Shkathësitë e buta janë attribute personale që na mundësojnë të punojmë, performojmë e bashkëpunojmë me të tjerët në mënyrë që të arrijmë të funksionojmë suksesshëm në shoqëri. Ato janë pjesë e jetës së përditshme të secilit prej nesh.

Shkathësitë e buta shpeshherë quhen edhe shkathësi njerëzore apo shkathësi ndërpersonale. Prandaj, ky është tregues i fuqishëm i rëndësisë së tyre në jetën personale dhe profesionale të secilit prej nesh.

Duke pasur parasysh rëndësinë e shkathësitë të buta, KCDF në bashkëpunim me GIZ CDDBE kanë zhvilluar dhe publikuar modulën e trajnimit mbi shkathësitë e buta. Ky modul është përshtatur për nevojat e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme dhe janë trajnuar tashmë mbi 175 nxënës.

Në të njëjtën kohë, Programi ASSET promovon shkathësitë e buta tek të gjitha gjimnazet partnere përmes materialeve informuese, trajnimeve, projekteve, garave, dhe inkurajimit të klubeve që t'i shtjellojnë ato. ASSET promovon në mënyrë ekskluzive 10 shkathësi të buta për nxënës, të cilat shkurtimit ilustrohen në posterin në vijim:

SHKATHTËSITË E BUTA

PËR JETË DHE PUNË

Jam mendimtar kritik

- Dua të jem i informuar drejt
- Arsyetoj duke u bazuar në fakte, të dhëna, informacione të verifikuara
- Arsyetoj gjykimet e mija
- Përdor logjikën
- Dalloj të gabuarën
- Marr parasysh rrethanat para se të marr qëndrim



Jam i ndërgjegjshëm

- Respektoj rregullat dhe udhëzimet e dakorduara
- Jam i përpiktë
- Planifikoj realizimin e aktiviteteve/ detyrave
- Menaxhoj mirë kohën
- Veprtoj me sinqeritet
- Reagoj ndaj sjelljeve jo-etike



Jam komunikues i mirë

- Flas dhe shkruaj qartë
- Për të qartësuar idetë, shfrytëzoj grafikone, vizatime, ilustrime
- Shfrytëzoj teknologjinë për të komunikuar idetë
- Përdor drejt gjuhën e trupit
- Përshitas tonin dhe shpejtësinë e zërit
- Përdor forma artistike për të shprehur idetë ose porosinë (shfaqje, instalacione, pantomimë, këngë, video, dramë, ekspozita, etj.)



Jam këmbëngulës

- Punoj vazhdimisht drejt arritjes së qëllimit
- Nuk dorëzohem lehtë para pengesave dhe dështimeve
- Jam i përqendruar gjatë kryerjes së detyrave
- Insistoj në ruajtjen e vlerave dhe standardeve përballë presioneve



Zgjidh problemet

- Jam praktik
- Identifikoj dhe kuptoj problemin
- Analizoj shkaktarët e problemit
- Propozoj dhe diskutoj opsione të mundshme për zgjidhje
- Zgjedh opsionin më të mirë të mundshëm
- Vlerësoj ndikimin e zgjidhjes së zbatuar



Punoj në ekip

- Respektoj secilin në ekip
- Kontribuoj me ide të reja dhe dëgjoj idetë e të tjerëve
- Marr dhe jap komente konstruktive
- Bashkëpunoj me të gjithë në ekip
- Ndihmoj të tjerët në ekip
- Marr përgjegjësitë e mija
- Jam tolerant dhe bëj kompromise për të arritur qëllimet e përbashkëta



Jam kreativ

- Ofroj ide të reja dhe inovative
- Kombinoj idetë e ndryshme në një ide të re, origjinale dhe unike
- Shfrytëzoj informacione dhe resurse të tjera (kohën, materialet, njerëzit, paratë) në mënyrë efektive
- Përdor elemente artistike gjatë aktiviteteve



Jam hulumtues

- Mbledh informacione nga burime të ndryshme
- Përdor edhe teknologjinë e informacionit për të hulumtuar
- Vërtetoj burimin, besueshmërinë dhe cilësinë e informacionit
- Analizoj dhe përpunoj informacionin
- Jam i vetëdijshëm se plagjiatura është shkelje



Kam inteligjencë emocionale

- Jam i matur në shprehjen e emocioneve
- Jam i durueshëm
- Reflektoj për situatat/veprimet
- Ndikoj në qetësimin e situatave
- Pranoj gabimet dhe kërkoj falje
- Bashkëndiej me të tjerët
- Jam i hapur ndaj kritikave



Kam shpirt ndërmarrësi

- I shndërroj idetë në veprime
- Marr iniciativa
- Marr parasysh rreziqet
- E ndaj vizionin tim dhe frymëzoj të tjerët
- Planifikoj resurset (buxhetin, kohën, ekipin, etj.) për të kryer një aktivitet
- Mësoj nga sukseset, dështimet apo gabimet
- Jam i gatshëm të nis nga fillimi



STORIET E SUKSESIT

ZHVILLIMI I MODULIT STORIET E SUKSESIT NË BUSULLA.COM

BUSULLA SQ | Testet e karrierës | Profesionet | Shkollat/Universitetet | Puna dhe praktika | Këshilltari | Kyçu



Dizajnere grafike

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë video nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Kjo video është financuar nga populli amerikan përmes Agjencionit të SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID Kosovë), në kuadër të Programit 'Përkrahje Adoleshentëve pas Mësimi të Rregullit' të USAID-it të cilin e zbaton Qendra për Arsimit të Kosovës (KEC) në partneritet me FHI 360 dhe Crimson Capital Corp.

Postuar:

Busulla - Rreth 2 vite me pare

1148 Shikime

Shpërfaqje

Qëllimi i storieve të suksesit

Busulla.COM ofron modulën *Storie suksesi* përmes së cilës përdoruesit mund të shohin video dhe ta kuptojnë rrugëtimin e të rinjve të suksesshëm në fushën e ndërmarrësisë, me qëllim që ata të motivohen për t'i ndjekur qëllimet e tyre.

Në video shfaqen individë të suksesshëm në profesione dhe fusha nga më të ndryshmet si dizajn, arkitekturë, ndërmarrësi, teknologji e kështu me radhë.

Këto video të storieve të suksesit ofrohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, duke ofruar kështu mundësinë për ta vizituar këtë modul të gjithë nxënësve dhe përdoruesve. Sikurse edhe shumë iniciativa dhe pasurime të tjera të platformës Busulla.COM, edhe këto video janë realizuar falë mbështetjes së programit ASSET.

"Jam i bindur që dallimi kryesor në mes të ndërmarrësve të suksesshëm dhe atyre të pasuksesshëm është pikërisht hezitimi" - Steve Jobs

RISITË NË BUSULLA.COM



Zyrtar/-e i/e marketingut

SHKOLLIMI

 Universitare

Platforma Busulla.COM përbëhet nga 5 module të ndryshme, prej të cilave moduli *Profesionet* është njëri ndër nga më të rëndësishmit. Ky modul përmban mbi 300 profesione të cilat shfletohen çdo ditë nga mijëra nxënës, studentë, mësimdhënës dhe përdorues tjerë të platformës.

Me mbështetjen e programit ASSET është arritur që profesionet e paraqitura në këtë modul të pasurohen edhe më tutje me informata adekuata rreth specifikave të profesionit dhe ambientit të punës. Disa nga intervenimet e bëra në këtë drejtim janë:

- Organizimi i *Sfidës së dizajnit*: garë në mes të gjimnazeve për zhvillim dhe montim të videove më të mira të profesioneve. Videot më të mira janë publikuar në platformë, që të shfrytëzohen nga të gjithë përdoruesit.
- Mbështetja e nxënësve praktikantë në KCDF për zhvillimin e videove të profesioneve: videot e realizuara nga praktikantët me mbikëqyrjen e stafit të KCDF-së janë përpunuar dhe përgatitur për publikim në platformë me mbështetjen e ASSET.

Më poshtë janë listuar profesionet e reja të publikuara dhe të qasshme nga të gjithë përdoruesit:

- Kriminolog/-e
- Zyrtar/-e i/e marketingut
- Shitës/-e i/e pllakave
- Fiziatër/-e
- Ortoprotetist/-e
- Farkëtar/-e
- Meteorolog/-e
- Regjisot/-e
- Operator/-e i/e makinave me dirigjim kompjuterik – CNC
- Arkitekt/-e
- Dizajnues/-e i/e softuerit

Përveç këtyre, në Busulla.COM mund të shfletoni edhe rreth 300 profesione me përshkrim rreth aktiviteteve, shkathësive, dhe njohurive, veglave të punës, shkollimit të nevojshëm, etj.



Operator/-e i/e makinave me dirigjim kompjuterik - CNC

SHKOLLIMI

 Shkollë e mesme profesionale

AKTUALITETI



Mesatarisht € 250 -1000

PAGA

STANDARDIZIMI I SHËRBIMEVE TË ORIENTIMIT NË KARRIERË NË TËRË TERRITORIN E VENDIT



Me qëllim të përfshirjes së të gjitha shkollave në tërë territorin e vendit për shërbimet e këshillimit dhe orientimit në karrierë, KCDF me mbështetjen e projektit EYE (Enhancing Youth Employment) është duke u bërë aftësimi i mësimdhënësve të shkollave publike të komunitetit serb në modulet e Busulla.COM.

Këta mësimdhënës janë duke u aftësuar në katër modulet e Busulla.COM, me rezultate të të mësuarit të cilat përfshijnë:

- Të kuptuarit e pesë hapave të procesit të orientimit dhe këshillimit në karrierë dhe mbështetja e nxënësve në këtë proces.

- Të kuptuarit e teorive kryesore të orientimit në karrierë dhe rolit të familjes, shoqërisë, mësimdhënësve dhe akterëve të tjerë.
- Njohja me aktivitetet jashtë-kurrikulare, rëndësia e organizimit të tyre dhe përfitimet për nxënës.
- Interpretimi i rezultateve të testeve të karrierës si Testi i Personalitetit (IVAP) dhe Testi për Vlerësim të Potencialit.

Përmes këtij trajnimi do të lehtësohet puna e mësimdhënësve në ofrimin e shërbimeve më të mira për nxënës, përderisa nxënësve do t'iu sigurohet mbështetje më efektive në vendimmarrje për karrierë.



ARRITJE DHE STATISTIKA RRETH ORGANIZATËS DHE PARTNERËVE TONË

Disa arritje dhe statistika mbresëlënëse rreth mbështetjes së shkollave për këshillim dhe orientim në karrierë janë:

- +285,000 përdorues të platformës zyrtare të MASH-it për orientim profesional, edukim dhe këshillim në karrierë, Busulla.COM.
- 16 Klube të Karrierës të ngritura nga ASSET në 16 gjimnaze. Këto klube pranojmë edhe mbështetjen e vazhdueshme të organizatës KCDF.
- 20 Klube të Karrierës të ngritura nga KCDF në mbështetje të GIZ CDBE në 20 shkolla të mesme të ulëta nëpër regjione të ndryshme të vendit.



- 10 Qendra të Karrierës të ngritura nga Projekti EYE – HELVETAS në 10 shkolla profesionale nëpër regjione të ndryshme të vendit. Këto Qendra të Karrierës mbështeten edhe nga KCDF përmes platformave në dispozicion dhe ofrimit të trajnimeve tek zyrtarët e qendrave siç janë:
 - Qendra për Këshillim në Karrierë Prishtinë
 - Qendra e Karrierës Vushtrri
 - Qendra e Karrierës Pejë
 - Qendra e Karrierës Gjakovë
 - Qendra e Karrierës Ferizaj
 - Qendra e Karrierës Kaçanik
 - Qendra e Karrierës Malishevë
 - Qendra e Karrierës Prizren
 - Qendra e Karrierës Prishtinë
 - Qendra e Karrierës Viti



FALEMINDERIT!

Informatat kontaktuese:

+383 (0) 44 507 575

info@koscdf.org

Xheladin Hana p.n. F.P. 315. 10000
Prishtinë, Republika e Kosovës

<https://koscdf.org/en/home-page/>

<https://www.facebook.com/KosovoCDF>

<https://busulla.com/>

